



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:074626

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05438773

**P.nr.177/19**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN– Departamenti i përgjithshëm**, gjyqtari Lulzim Hoxha, me bashkëpunëtoren profesionale Afërdita Kicaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit: O. (R.) Sh., nga Prizreni, rr. “.....”, nr....., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 para.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.3355-7/18, të datës 30.01.2019, në bazë të nenit 357 par.1 nënpar.1.3.të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së) dhe nenit 12 par.12.5.të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, jashtë seancës, më datë 11.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim, e lidhur në mes të pandehurit: O. (R.) Sh., nga Prizreni, rr. “.....”, nr..... dhe të dëmtuarit KEDS SH.A-Distrikti në Prizren, në Zyrën e Ndërmjetësimit në Prizren, me datë **28.02.2024**.

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.3355-7/18, të datës 30.01.2019, dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit: O. (R.) Sh., nga Prizreni, rr. “.....”, nr....., **për shkak se i pandehuri dhe i dëmtuari kanë arritur marrëveshjen për ndërmjetësim**.

**III.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore te kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.3355-7/18, e datës 30.01.2019, ka akuzuar të pandehurin O. (R.) Sh., nga Prizreni, rr. “.....”, nr....., për shkak se ka kryer veprën penale, vjedhje e shërbimeve nga neni 314 para.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë, ka filluar seancën e shqyrtimit fillestar, në çështjen penale ndaj të pandehurit O. (R.) Sh., për shkak se ka kryer veprën penale, vjedhje e shërbimeve nga neni 314 para.1 të KPRK-së, dhe në fillim të seancës e cila është mbajtur me datë 28.02.2024, i pandehuri ka propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet në procedurën e ndërmjetësimit, të cilin propozim nuk e ka kundërshtuar Prokurori i Shtetit, ashtu që edhe gjyqtari e ka ndërprerë seancën dhe i ka udhëzuar palët se këtë çështje mund ta zgjidhin edhe me ndërmjetësim.

Me datë 28.02.2024, në Zyrën e Ndërmjetësimit në Prizren, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet pandehurit O. (R.) Sh., nga Prizreni, rr. "Bashqarshija", nr.3 dhe të dëmtuarit KEDS SH.A-Distrikti në Prizren, i pandehuri është pënduar thellë për veprimet e bëra dhe premtoj se nuk do të përsërisin veprime të tilla kundërligjore.

Palët pa ndonjë kërcënim dhe me vet dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje për zgjidhjen e ndërmjetësuar dhe nuk e kontestojnë asnjë nga pikat e lartpërmendura.

Zyra për Ndërmjetësim me datë 28.02.2024, me nr. ref. të ndërmjetësimit Ndm.76/24, ka lidhur marrëveshjen e palëve për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 357 par.1 nën paragrafi 1.3.të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), dhe nenit 12, par.12.5 të Ligjit mbi Ndërmjetësim, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.177/19, datës 11.03.2023**

**Bashkëpunëtore Profesionale**  
**Afërdita Kicaj**

**Gjyqtari**  
**Lulzim Hoxha**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.  
**Kjo marrëveshje e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.**